

REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI

Kryetari



RAPORT

**PËR SITUATEN EKONOMIKE FINANCIARE DHE ZBATIMIN E PLANEVE
INVESTUESE PËR PERIUdhËN JANAR-QERSHOR 2020**

Shtator 2020

Të nderuar/a anëtar/e të Kuvendit,

Sikurse edhe në raportimet e mëhershme lidhur me situatën ekonomike e financiare dhe zbatimin e planeve investuese edhe në këtë raport jemi bazuar në planifikimin që është bërë në këtë vit si për projektet prioritare ashtu edhe për punët dhe aktivitetet për secilën drejtori dhe sektorë me qëllim të përmbushjes së objektivave të përcaktuara me planifikimin që është bërë, në bazë të të cilit kryetari i komunës e ka për obligim që të raportoj para anëtarëve të kuvendit.

Për dallim me vitet e kaluara këtë gjashtëmuorë jemi ballafaquar me probleme dhe vështirësi të shumta në punë për shkak të rrethanave të krijuara nga pandemia COVID-19. Siç është e ditur që nga mesi i muajit mars 2020 me paraqitjen e rasteve të para të të infektuarve në Kosovë, si komunë kemi ndërmarr hapat e parë të masave për parandalimin e shfaqjes dhe përhapjes së kësaj sëmundje. Fillimisht kemi themeluar Shtabin Komunal Emergjent i cili ka qenë aktiv 24 orë duke përcjellë në vazhdimësi situatën në terren. Në luftë për përballimin e kësaj sëmundje janë bashkëngjitur edhe grupi i të rinjve vullnetarë nga komuna jonë të cilët në kontiunitet janë angazhuar në shpërndarjen e ndihmave të siguruara qoftë nga buxheti i komunës ashtu edhe nga donatorë të ndryshëm për familjet në nevojë si dhe familjet të cilat për një kohë kanë qenë në karantinë apo edhe më vonë në izolim.

Si hap të parë kemi propozuar ndarjen e mjeteve buxhetore në shumë prej 200,000 00 € për financim të masave për parandalim të pandemisë COVID-19 ku nga ato mjete kemi parapa të blihen pako ushqimore dhe higjienike për familje skamnore (gjithsejtë 50,000 €). Gjithashtu janë blerë pajisje mbrojtëse (maska, dorëza, mjete dezinfektueses etj.) për stafin shëndetësor të komunës dhe zyrtarët institucional të angazhuar gjatë kësaj pandemie. Duke iu falënderuar donatorëve të shumtë kemi vazhduar me shpërndarjen e ndihmave ushqimore dhe higjienike për familjet në asistencë sociale dhe atyre nevojë të cilat kanë qenë të prekura nga kjo pandemi.

Në mbledhje të jashtëzakonshme të kuvendit kemi propozuar vendime të cilat janë miratuar siç janë: për lirim nga pagesat e taksave dhe qirasë komunale për të gjitha pronat e komunës që janë dhënë në shfrytëzim. (Afati i lirimit nga 01.03. 2020 deri 31.12.2020), Vendimi për shtyrjen e afatit të pagesës së kësteve për leje ndërtimore për objektet e kategorisë së dytë. (afati i shtyrjes - 3 muaj nga dita e arritjes së obligimit për pagesë), si dhe Vendimi për lirim nga pagesa e tarifës për fëmijë në Qerdhen e fëmijëve "Foleja" në Vushtrri. (afati nga 01.03.2020 deri në fillim të vitit të ri shkollor 2020-2021).

Për shkak masave kufizuese që është dashur të merren nga niveli qendror, ku janë ndaluar që të ushtrohen veprimtaritë biznesore, me kalimin e kohës është pa se bizneset kanë pësuar dëme të konsiderueshme financiare. Andaj, si komunë krahas veprimeve në fushën e shëndetësisë si: furnizimi me barna dhe material mbrojtës për personelin shëndetësorë në rend të parë edhe për zyrtarët komunal etj. është dashur që të marrim hapat fillestar për të menduar se si mund të iu dalim në ndihmë bizneseve të komunës për përballimin sa më me pak pasoja të kësaj gjendje. Kështu që në mbledhje emergjente të kuvendit të komunës kemi propozuar miratimin e vendimit për inicim të procedurës për vlerësim të dëmeve të bizneseve të komunës.

Me propozim të kryetarit në mbledhje të kuvendit i kemi liruar disa kategori të qytetarëve nga detyrimet që i kanë pas ndaj komunës, marrë parasysh faktin që shumica dërmuese e bizneseve nuk kanë punuar, dhe e gjithë kjo është reflektuar edhe në zvogëlimin gjegjësisht mosrealizimin e të hyrave të planifikuara buxhetore.

Poashtu, me vendim të Qeverisë së Republikës së Kosovës janë marrë mjete buxhetore nga kategori të ndryshme nga buxheti i komunës kështu që është dashur që të heqim dorë nga disa projekte të cilat kanë qenë të planifikuara për këtë vit dhe rrjedhimisht, do të jetë vështirë që deri në fund të këtij viti të mund të i përmbushim objektivat tona të parapara

Gjithashtu kemi qenë të detyruar që të reduktojmë stafin dhe të punojmë me staf esencial në mënyrë që të zvogëlojmë mundësinë e përhapjes së këtij virusi te të punësuarit në organet e administratës.

Kjo situatë për sa i përket përhapjes së virusit COVID-19 siç e dimë është duke vazhduar edhe tani dhe me pasoja shumë të rënda si në humbje të jetëve në njerëz, dëmtim të bizneseve, poashtu edhe në humbje të vendeve të punës dhe përkeqësim të gjendjes materiale në shumë ekonomi familjare.. Kjo gjendje e rënduar ekonomike mund të rëndohet edhe më tepër nëse kjo pandemi do të vazhdoj për një kohë më të gjatë.

Lidhur me masat që i kemi ndërmarrë si komunë për sa i përket luftimit të pandemisë covid-19, në mënyrë të detajuar në shtojcë gjeni të bashkëngjitur informatë të detajuar, ndërsa në vijim janë paraqitur punët që janë bërë brenda këtij gjashtëmujori në secilën drejtori:

Buxhet dhe Financa

Me përfundimin e vitit fiskal 2019 kemi filluar përgatitjet për fillimin e vitit fiskal 2020 ,duke evidentuar së pari obligimet e pa paguara nga viti i kaluar qe kanë qene në shumë prej:106,760.08.

Kemi bërë barazimet me sistemin e free balancit dhe kemi hartuar pasqyrat financiare për vitin fiskal 2019.

Kemi përgatit dokumentacionin e nevojshëm për fillimin e vitit fiskal 2020, ku kemi caktuar me kohë personat përgjegjës për autorizimin e shpenzimeve dhe personat përgjegjës që punojnë në sistemin e free balancit.

Kemi bërë bartjen e të hyrave të pa shpenzuara nga viti 2019 që kanë qenë në shumë prej 1,356,263.33

Me pagesa kemi filluar me datën 08.01.2020 dhe së pari i kemi krye faturat e pa paguara nga viti paraprak ,pastaj kemi vazhduar me faturat e vitit vijues dhe me disa përjashtime të vogla faturat i kemi kryer brenda afatit ligjor 30 ditë nga marrja e faturës.

Kemi pranuar 732 fatura dhe brenda ditës janë dorëzon në prokurim dhe te personat tjerë përgjegjës.

Në janar kemi raportuar në Kuvendin e Komunës për raportin vjetor të hyrave dhe shpenzimeve

në baza tre mujore bëhet barazimi i të hyrave dhe shpenzimeve me sistemin e free balancit, si dhe raportimi në Kuvendin e Komunës.

Në majin prill komform ligjit kemi bërë raportimin në kuvend për tre mujorin e –I- për të hyrat dhe shpenzimet.

Në majin prill në seancën e jashtëzakonshme kemi bërë ridestinimin e mjeteve nga kapitale në mallra dhe shërbime në shumën 200,000.00 për përballimin e pandemisë covid-19.

Në majin maj kemi marrë qarkoren buxhetore 01/2021 nga MF me kufijtë e caktuar dhe së bashku me të gjitha drejtorit kemi harmonizuar kërkesat për vitin 2021.

Në muajin qershor e kemi dorëzuar në Kuvend kornizën afatmesme të buxhetit për vitet 2021-2023.

Gjatë kësaj periudhe janë proceduar për pagesa nga ana e zyrtarëve shpenzues dhe certifikues 1372 lëndë. Shuma e përgjithshme 607,523.80

Drejtoria për buxhet dhe financa bënë inkasimin pjesës më të madhe të hyrave komunale dhe ate nga tatimi në pronë, por këtë vit për shkak të pandemis Covid-19 realizimi i të hyrave nga tatimi në pronë për këtë periudhë është më i vogël për 32,622.28 € në krahasim me vitin e kaluar. Të hyrat vetanake të planifikuara për tatimin në pronë kanë qenë në shumën 403,634.00 €, kurse janë realizuar 270,976.68 € ose 67.13 %

Meqenëse se drejtoria për buxhet dhe financa kryen shërbime për të gjitha drejtorit e tjera sa i përket planifikimit dhe realizimit të buxhetit, ne po e paraqesim në vija të trasha planifikimin dhe realizimin e buxhetit ,kurse për shënime analitike është raporti vjetor i të hyrave dhe shpenzimeve ,si dhe pasqyrat financiare që do të paraqiten në K.K . pas auditimit nga ana e auditorit të përgjithshëm.

Planifikimi i buxhetit Janar-Qershor/2020 është si në vijim

• Paga dhe mëditje.....	5,137,199.85€
• Mallra dhe shërbime.....	1,941,586.07€
• Shpenzime Komunale.....	163,519.34€
• Subvencione dhe transfero.....	215,865.09€
• Investime kapitale.....	3,357,115.15€
Totali.....	10,815,285.50€

Buxheti i planifikuar dhe shpenzimet e realizuara,

Përshkrimi	Kodi	Periudha raportuese(Janar-Qershor 2020)		
		Buxheti i planifikuar	Shpenzimet të realizuar	Përqindja e buxhet të realizuar
		4	5	6 = 5/4*100
		€	€	%
Paga dhe mëditje	111	5,137,199.85	5,065,483.96	99%
Mallra dhe shërbime	130	1,941,586.07	959,790.80	49%
Shpenzimet komunale	132	163,519.34	123,423.63	75%
Subvencionet dhe transferet	200	215,865.09	6,665.00	3%
Investimet kapitale	300	3,357,115.15	1,653,887.75	49%
TOTALI		10,815,285.50	7,809,251.14	72%

Ekonomi Bujqësi Pylltari

Sektori për biznes : Qendra komunale e biznesit është e orientuar drejt zhvillimit, që ofron arritjen e efikasitetit më të madh, me një cilësi më të lartë për të gjitha bizneset që operojnë në komunën tonë.

Ky sektor nga viti I kaluar ka lansuar platformën e re elektronike për regjistrimin onl-ine të bizneseve, përmes sistemit çdo qytetar mund të aplikoj për regjistrimin e bizneseve, kërkesa për ndryshim dhe shërbime të tjera. Për të hyrë në sistem kërkohet që paraprakisht të ketë llogari të konfirmuar në sistem. Sistemi i tanishëm ka ndikuar në rritjen e transparencës, si dhe ka një rritje të standardeve dhe përpjekjeve për të harmonizuar procedurat e regjistrimit me direktivat e Bashkimit Evropian.

Prej 01.01.2020 deri më 30.06.2020 në QKB në Vushtri janë kryer këto shërbime:

<u>Nr.</u>	<u>Përshkrimi i aktivitetit</u>	<u>Nr.i llojit</u>	<u>Vërejtje</u>
1.	Biznese të reja (të regjistruara) individuale	64	
2.	Biznese te reja (te regjistruara) Shoqëri me përgjegjësi te kufizuara	85	
3.	Biznese të shuara	33	

4.	Ndërrime të logove të certifikatave	199
5.	Ndryshime në bizneset ekzistuese	98

Siç shihet nga të dhënat e mësipërme, në gjashtëmuorin e parë të vitit 2020 numri i bizneseve të reja të regjistruara në QKB është 149 biznese.

Në vazhdim do të japim pasqyrën tabelare të bizneseve të regjistruara

Kodi	VEPRIMTARIT EKONOMIK	Bizneset prej 01.01-30.06.2020	%
A	Bujqësia, Gjuetia dhe pylltaria	7	4.7
B	Peshkimi	-	
C	Industria e Minierave dhe Ekstraktuesve	1	0.67
D	Industria përpunuese	26	17.44
E	Furnizimi me energji elektrike dhe ujë	3	2.01
F	Ndërtimtaria	15	10.1
G	Tregtia me shumicë dhe pakice riparimi i automjeteve dhe aparateve tjera të amvisëri	36	24.16
H	Hotelet dhe Restorantet	13	8.72
I	Transporti,depot dhe telekomunikacion	7	4.7
J	Aktivitetet Financiare	7	4.7
K	Pasurit e patundshme:dhënia me qira dhe aktivitetet e biznesit	19	12.75
M	Administrimi dhe Mbrojtja publike Mbrojtja e obligueshme sociale	3	2.01
N	Arsimi	2	1.34
O	Aktivitet tjera shoqërore dhe personale	10	6.71
	Totali	149	100

Siç shihet nga të dhënat e mësipërme nga bizneset e regjistruara për periudhën 01.01. deri më 30.06.2020 (ne gjashtëmujorin e pare te vitit 2019 kane qene 228 biznese te reja te regjistruara), edhe më tutje dominon veprimtaria tregtare 24.16 % apo 36 biznese nga gjithsej sa janë të regjistruara, (krahasuar me gjashtëmujorin e vitit te kaluar kane qene biznese 58 apo 23.32 %) pastaj industria përpunuese me 26 biznese sa janë të regjistruara apo me 17.44 %, ndërtimtaria me 15 biznes etj.

Sektori i bujqësisë

Gjatë këtij gjashtë mujorit në sektorin e bujqësisë janë zhvilluar këto aktiviteteteve,

1. Projekti ne bashkëfinancim me organizatën IRW-

Ky projekt është duke u implementuar ku kemi bërë shpërndarjen për përfituesit:

*Pula 148 përfitues me nga (50 pula).

*Serra me sipërfaqe prej 1(një) ari për 17 përfituese

*Në proces janë edhe shpërndarja e Lopëve dhe Deleve.

Në proces janë edhe për 20 përfituese me nga 50 pula

Në proces është edhe shpërndarja e ushqimit (koncentratit) të pulave për të gjithë përfituesit
Është hapur edhe një pus.

2. Projekti me serra ne sipërfaqe prej 50m²

Nr.	Lloji i investimit	Nr. i përfituesve	Participimi	Komuna	Shuma
1	Ngritja e Serave	151	200*149=29,800.00€	60,400.00€	90,200.00€

Vërejtje: dy serra i janë dhënë pa pagesë Shoqatës “Handikos” në Vushtri.

3. Projekti Rimorkio për shpërndarjen e plehut organik

Art.	Përshkrimi i mallit	Njësia	Sasia	Çmimi i njësisë	Çmimi total
1	Rimorkio për shpërndarjen e plehut organik	copë	7	5,142.85€	36,000.00€

Komuna	30,000.00 €
Përfituesit	6,000.00 €, (7*857.14€)

Vërejtje: Ky projekt është i mbetur nga viti i kaluar.

Sektori i pylltarisë

Janë bërë përpjekje për ruajtjen dhe mbrojtjen e pyjeve dhe resurseve pyjore nga prerësit ilegal dhe dëmtuesve tjerë.

Masat që janë ndërmarr:

Nr.	Veprimet e ndërmarr	SASIA	VREJTJE
1.	Kërkesa të paraqitura për leje-prerje	23	
2.	Kërkesa të realizuara	7 copa=273.84m ³	
3.	Damkosje, dru zjarri	7 copa=273.84m ³	
4.	Vulosje, dru zjarri	5=20.50 m ³	
5.	Fletëpagesa p. private	3=192.50€	
6.	Fletëpagesa- shitje nga depoja	0 €	
7.	Konfiskime	4 =22.00m ³	
8.	Gjendja në depo	33.20 m ³	
9.	Zjarre në pyje	496.30 h	
10.	Fletëparaqitje kundërvajtje penale	55 = 97,92m ³ = 13174.20€ 1=3.18m ³ =846.54€	
11.	Plani i ri pyllëzimeve		
12.	Kontrolla terreneve	35	

Ne këtë gjashtëmuor kemi bërë plan operativ në bashkëpunim me Polici në mënyrë që ta parandalojmë qarkullimin e pa ligjshëm të masës drunore në qytet, treg dhe akse rrugorë si dhe në terrene, ku si rezultat i saj kemi edhe konfiskime.. Gjate kësaj periudhe kemi bere kontrole ne te gjitha terrenet si dhe Qytet-Treg dhe akset rrugore. Bashkëpunim te mire kemi me zyrën Koordinuese ne Mitrovice si dhe me Stacionin Policor ne Vushtri, ku për terrenin e Sllakovcit kemi bërë plan operativ te veçante.

Administrata

Zyra e Gjendjes Civile gjatë kësaj periudhe ka ofruar të gjitha shërbimet që kryhen në këtë shërbim si për qytetarët ashtu edhe për institucionet. Gjatë periudhës së pandemisë prej datës 13.03.2020, i kemi marr të gjitha masat për të ruajtur distancën dhe po ashtu i kemi obliguar të gjithë nëpunësit që përdorim maskat mbrojtëse dhe dorëzat gjatë kontaktit dhe ofrimit të shërbimeve për qytetar.

Prej datës 16.03.2020 kemi filluar të punojmë me kujdestari dhe me numër të zvogëluar të nëpunësve gjatë gjithë kohës së pandemisë.

Gjatë kësaj periudhe janë dhënë këto shërbime:

Lëshimi i certifikatave dhe dokumenteve të Gjendjes Civile -18267, ndërsa regjistrime të fakteve të lindjeve, të vdekjeve janë kryer - 360 fakte.

Gjatë kësaj periudhe janë kryer 169 kurorëzime të qytetarëve dhe janë regjistruar 8 martesë të lidhura jashtë Kosove.

Po ashtu, gjatë kohës së pandemisë qytetarëve iu është mundësuar kryerja e shërbimeve online, zhvillimi i platformës për qytetarët të cilët janë kthyer nga jashtë vendit të lajmërohen online. Gjithashtu fermerëve iu është mundësuar përmes platformës së Viber-it në mënyrë online të aplikojnë për dokumente dhe shërbime të ndryshme.

Arsimi

DKA në Vushtrri ka bërë përgatitjet e duhura për fillimin e gjysmë vjetorit të dytë të vitit shkollor 2019/2020 i cili ka filluar , sipas kalendarit të vitit shkollor. Mësimi i rregullt ka vazhduar normalisht në të gjitha institucionet arsimore deri më datën 12.03.2020 ku me Vendim të Qeverisë është ndërprerë mësimi në të gjitha nivelet e arsimit.

Nga data 13.03.2020, siç ka paraparë vendimi i Qeverisë së Republikës së Kosovës, për ndërprerjen e procesit mësimor në të gjitha nivelet e arsimit në Republikën e Kosovës, Vendim ky i cili ka mobilizuar të gjithë akterët e nevojshëm dhe po zbatohet me mjaft përkushtim.

Drejtoria Komunale e Arsimit në komunën e Vushtrrisë ka përcjellë vazhdimisht punën e mësimi në distance, ka qenë në kontakt të vazhdueshëm me shkollat prej nga ka marrë vazhdimisht informata për mbarëvajtjen e mësimi, angazhimit të mësimdhënësve, nxënësve e prindërve dhe në baza ditore pothuajse ka raportuar në zyrën e kryetarit dhe Shtabin Emergjent Komunal anti COVID10 e po ashtu sipas udhëzimeve të MASH, në baza javore dhe mujore ka raportuar në MASH.

Duke pasqyruar punën e DKA-së, drejtorëve, mësimdhënësve, nxënësve dhe personelit tjetër arsimor, për përfundimin e gjysmë vjetorit të dytë të vitit shkollor 2019/2020, në këtë gjysmë vjetor ka pasur suksese dhe sfida në përmbushjen e objektivave të përcaktuara.

Punët e kryera:

- Caktimi një koordinatori të IT- për të ju ofruar ndihmë mësimdhënësve rreth platformave elektronike.
- Janë trajnuar mësimdhënës nga UBT rreth platformave.
- Sesion i organizuar nga DKA për të gjithë kujdestarët e klasave të IX-ta rreth orientimit në karrierë.
- Pajisja e nxënësve me teknologji nga donatorët me 170 pajisje (140 llaptopë dhe 30 tableta) LONI DEKOR- Mitrovicë ; 5 llaptopë, EKOLOG- Tetovë; 30 tableta, BINI-Vushtrri; 27 llaptopë, VIPA- Vushtrri; 30 llaptopë, UNION – Vushtrri; 20 llaptopë, BENI SHOP – URBAN GRUP- Vushtrri; 15 llaptopë GERMAN- COLOR- Vushtrri; 14 llaptopë, BPC-Prishtinë ;10 llaptopë, ELKOS-Prishtinë ;19 llaptopë
- Shpërndarja e 100 pako me mjete mësimore të dhuruara nga CIAO Berto.
- Është themeluar ekipi komunal "Së bashku kundër abuzimit të fëmijëve" si dhe janë zgjedhur të gjitha ekipet në shkollat të mesme të ulëta, projekt ky i zbatuar më organizatën KEC & FIT .

- Është arrit marrëveshja e bashkëpunimi për qendra mësimore në mes të komunës dhe OJQ "VoRAE" për themelimin e Qendrës Mësimore në fshatin Prelluzhë.
- Vlerësimi përfundimtar : janë realizuar procedurat e vlerësimit të nxënësve gjatë mësimin në distancë në të gjitha nivelet e arsimit para universitar. Nota përfundimtare nuk është vendosur me e ultë së ajo para datës 11 mars 2020 kur është ndërprerë mësimi i rregullt. Dëshmitë e mbledhura për punën e nxënësve në distancë janë ruajtur në ditarët e klasave, janë vendosur notat në librin amë sipas procedurave të caktuara. Janë plotësuar dëftesat dhe librezat e nxënësve. Janë mbajtur riprovime klase për nxënës të shkollave të mesme të larta.
- Janë kryer punimet e vrazhda të çerdhes së re afër shkollës "Ali Kelmendi".
- Janë kryer punimet e vrazhda për shkollën e re të muzikës.
- Janë në përfundim punimet e vrazhda në ndërtimin e sallës së sportit në SHMU-1.
- Furnizimi dhe montimi perdeve për 11 shkolla gjithsej 3946.21 euro.
- Është hap pusi për SHFMU "Adem Voca" Pasomë nga organizata SH.E.K "QËNDRESA KOSOVARE".
- Janë rregulluar tualetet në shkollën e Studimes së E. donacion nga KFORI slloven .

II. Suksesi i gjysmë vjetorit të dytë viti shkollor 2019/ 2020, krahasuar me vitin paraparak në periudhën e njëjtë

Gj.II.Periudha e njëjtë	GJ.II. Viti shkollor 2019/2020 klasa I- V												
	Shkëlqyeshëm	%	Sh. mirë	%	Mirë	%	Mjaftueshëm	%	Të pa notuar	%	Të pamjaftueshëm	%	Gj.
2020	364 1	69. 6	926	17. 7	513	9.8	148	2.8 2	1	0.0 19	0	0	523 1
2019	345 4	64. 94	105 5	19. 83	610	11. 5	189	3.5 53	7	0.1 3	4	0.0 75	531 9
Krahasueshmëria	187	4.6 6	- 129	- 2.1 3	-97	-1.7	-41	- 0.7 3	-6	- 0.1 1	-4	- 0.0 8	-88

Suksesi kl.I-V		
GJ.II , Periudha e njëjtë	Pozitiv	Negativ
2020	5231	0
2019	5319	4
Krahasueshmëria	-88	-4

GJ.II , Periudha e njëjtë	Gj.II viti shkollor 2019/2020 VI-IX													
	Shkëlqyeshë m	%	Sh. Mirë	%	Mirë	%	Mjaftueshëm	%	Të pa notuar	%	pamjaftueshë m	%	GJ	
2020	146 4	34. 4	986	23. 19	120 0	28. 22	588	13. 83	9	0.2 1	5	0.1175 92	425 2	
2019	124 3	27. 6	969	21. 5	124 5	27. 83	746	16. 56	14	0.3 1	168	3.73	450 6	
Krahasuesh meria	221	6.8 4	17	1.6 9	-45	0.3 9	- 158	- 2.7 3	-5	-0.1	- 163	- 3.6124 1	- 254	

Suksesi kl VI-IX		
GJ.II , Periudha e njëjtë	Pozitiv	Negativ
2020	4247	5
2019	4458	48
Krahasueshmëria	-211	-43

GJ.II , Periudha e njëjtë	Gj.II viti shkollor 2019/2020 X-XII												
	Shkëlqyeshëm	%	Sh. Mirë	%	Mirë	%	Mjaftueshëm	%	Të pa notuar	%	pamjaftueshë	%	GJ.
2020	412	15.32	575	21.38	923	34.3	689	25.61	4	0.149	87	3.2342	2690
2019	350	10.96	577	18.07	393	12.3	581	18.19	25	0.78	721	22.5	3193
Krahasueshmëria	62	4.36	-2	3.31	530	22	108	7.42	-21	-0.63	-634	-19.27	-503

Suksesi kl. X-XII		
GJ.II , Periudha e njëjtë	Pozitiv	Negativ
2020	2603	87
2019	2472	721
Krahasueshmëria	-183	-30

Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale

Në kuadër të drejtorisë janë kemi arritur që të kryhen këto punë:

- Kemi siguruar pajisje mjekësore moderne për shërbimin e urgjencës në Vushtri, pajisje të cilat për herë të parë i ka një shërbim i urgjencave nga të gjitha komunat e Kosovës.
- Kemi filluar për herë të parë me shërbimin stomatologjik në QMF Pantinë dhe së shpejti do të fillojmë edhe në QMF Lumadh.
- Kemi siguruar donacion një Autoambulancë të kompletuara me gjitha pajisjet nga Holanda për shërbimin e urgjencës.
- Jemi në fazën finale të përgatitjes me fillimin e punimit të analizave laboratorike që nuk janë punuar në laboratorin e Vushtrisë deri me tani, kemi disa vonesa për shkak të pandemisë pasi furnizimi me reagensët e nevojshëm bëhet nga Kina si vend i origjinës dhe për të njëjtët është bërë problem në mbarë botën.

- Po vazhdon ndërtimi i Qendrës së Mjekësisë Familjare në zonën urbane të tregu aktual një pjesë që do të ndikojë shumë pozitivisht në zoonimin e qytetit në aspektin e marrjes së shërbimeve mjekësore. Kjo qendër synohet të bëhet Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare dhe do të ofrojë hapësirë dhe kushte shumë të mira për pacientet dhe personelin shëndetësor.
- Kemi fuqizuar dhe rritur kapacitetet e shërbimit të terrenit për rastet e sëmundjeve kronike nga marrëveshja që kemi me Islamic Relief.
- Si Drejtori e Shëndetësisë dhe si QKMF me gjitha kapacitete jemi duke dhënë maksimumin për të qenë afër qytetarëve dhe menaxhimit më të mirë të situatës me pandeminë. Ekipet tona po vazhdojnë të vizitojnë rastet e prekura, të furnizojnë me terapi simptomatike, të kontaktojnë vazhdimisht përmes telefoni. Po ashtu jemi 24 orë në pikën kufitare në Jarinjë, në përgjigje të vazhdueshme në rastet e terrenit, tashmë edhe në hyrje të komunës dhe çdo kund ku është nevojta.
- Si Drejtori e Shëndetësisë pothuajse kemi dyfishuar buxhetin për barna dhe reagensa për analiza laboratorike në mënyrë që të ofrohet furnizim më i mirë për pacientet si dhe shërbime të reja.
- Jemi në procedurë të blerjes së një veture për shërbimin e “Vizitave të nënave, lehonave dhe fëmijëve”.
- Jemi në procedurë po ashtu të blerjes së pajisjeve të reja mjekësore të nevojshme për QKMF.

Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare

Pacientet të cilët kanë marrë shërbime shëndetësore në QKMF-QMF dhe AMF Vushtrri, në periudhën kohore prej **01.01.2020-31.06.2020**:

Janë ofruar këto shërbime: vizita konsultime nga mjekët familjar shërbimi i stomatologjisë Shërbime Urgjencës **24orë**, dhoma e infuzioneve, dhoma e tretmanit, dhoma e vaksinimit, këshillimorja për planifikim të familjes, këndi i rehidrimit, dhoma e inhalimit, dhoma e lidhtores, laborator, rëntgeni, RTG e dhëmbit si dhe vizitat shtëpiake për shtatzëne dhe për të sapolindurit dhe fëmijët deri në moshën 3 vjeçare etj.

Numri i përgjithshëm për jan.- qersh. 2020		
Pacientë	Shërbime	Participime
84.218	302,395	11767

Emri i shërbimit	Gjithsejta	Shërbim
Këshillimorja AQH	246	945

Emri i shërbimit	pacient	Shërbime
Relief Islamik	3,111	15,001

Shërbimet shëndetësore në QKMF, QMF dhe AMF

Nr,	Institucioni	Shërbimet
1	QKMF-Vushtrri	62434
2	Urgjenca	56933
3	Laboratori	51803
4	Stomatologji	17255
5	RTG	4243
6	Rtg e dhëmbit	516
7	Vaksinimi	12595
8	QMF-1	38091
9	QMF-2	6277
10	QMF-3	7547
11	QMF-AMF	23880
12	Vizita Shtëpiake Fëmijë dhe gra shtatzëna	4875
13	Këshillimore	945
15	Relief Islamik	15001
	Gjithsej;	302,395

Qendra për Punë Sociale

Asistenca Sociale

Në Asistence Sociale janë 1455 familje, prej tyre 1403 familje me 6597 anëtarë janë shqiptarë si dhe 52 familje me 1689 anëtarë janë minoritete.

Në këtë periudhë raportuese është punuar edhe me pakon 15 të Qeverisë së Kosovës - ndihmë qytetarëve në kohë të pandemisë, me qe rast janë regjistruar 2640 lëndë, kërkesa të cilat janë në procedurë e sipër dhe në shqyrtim si dhe është bërë shpërndarja e pakove ushqimore dhe higjienike për popullatën e komunës së me afër 1500 pako, Te gjitha këto, donacion nga donator të ndryshëm si dhe 1000 pako nga Komuna.

Shërbimet Sociale

Në periodën raportuese krahasuar me vitin paraprak t numri i klientëve ka qenë më i madh si rezultat i trajtimit të kategorive të reja, dhe e gjithë kjo ka rezultuar edhe me rritjen e volumit të punëve dhe ofrimit të shërbimeve përmes formave të mbrojtjes sociale.

Janë trajtuar këto kategori: Fëmijët pa kujdes prindor, të miturit me sjellje të çrregulluar dhe delikuenca e të miturve, viktimat e trafikimit, dhuna në familje, personat e moshuar etj.

Të dhënat sipas rasteve: Asistime ne polici për fëmijët e mitur dhe raste te dhunës në familje 22, Pjesëmarrje në séancë gjyqësore 31, Vizita në familje 50,

Kontaktim prind fëmijë 72, Seanca konsultime dhe këshillime 92 Bashkëpunim me Institucione 74, Konstatime Zyrtare 6

Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit

Spektori i Urbanizmit:

Kushte Ndërtimore:

Për objektet e kategorisë së parë (I) të ndërtimeve	13
Për objektet e Kategorisë së dytë (II) të ndërtimeve	6
Në proces janë gjithsejtë raste.....	6
Pëlqime	1
Refuzime kanë qenë	2
Të Hedhura poshtë	2
Informime për plotësim të lëndëve	4

Leje Ndërtimi :

Për objektet e kategorisë së parë (I) të ndërtimeve janë dhënë tetë (8) leje ndërtimi.

Për objektet e kategorisë së dytë (II) të ndërtimeve janë dhënë dy (2) leje ndërtimi.

Leje Mjedisore Komunale

Janë lëshuar 5 (pesë) Leje Mjedisore Komunale për realizimin e ndërtimit të objekteve.

Të hyrat e inkasuara nga taksat për Leje ndërtimore dhe Leje Mjedisore Komunale për këtë periudhë janë në vlerë prej **62,632.32€** si dhe taksat për Legalizimin e objekteve janë në vlerë prej **2062.45€**

Spektori i planifikimit:

Kërkesa nga palët:

Pëlqime paraprake	17
Pëlqime tjera	4
Shfrytëzim të hapësirave publike	3
Refuzime të hapësirave publike	4

Refuzime	2
Informime nga plani (PZHK)	3
Në proces	6

Gjatë periudhës Janar-Qershor 2020 nga Drejtoria e Urbanizmit dhe Mbrojtjes së Mjedisit janë hartuar këto projekte:

1. Projekti i Stacionit të autobusëve;
2. Projekti i Lumit Silnica;
3. Projekti i shtegut të biçiklistëve tek lumi Podranqa;
4. Projekti i Tregut për Prodhuesit vendor.
- 5.

Harta Zonale e Komunës së Vushtrrisë:

Komuna e Vushtrrisë ka lidhur Marrëveshje Mirëkuptimi me Un-Habitat-in duke siguruar donacion në vlerën 165,000.00€.

Deri më tani nga puna e përbashkët DUMM – UN-HABITAT janë incizuar dhe vektorizuar të gjitha objektet e zonës urbane dhe shumica e objekteve në zonën rurale në sistemin GIS.

Datebazë – mbledhja e të dhënave në teren përfshinë: digjitalizimi i linjave të sistemit të Ujësjiellit dhe Kanalizimit në tërë territorin e Komunës së Vushtrrisë; linjat telefonike te Telekomit dhe operatorëve të ndryshëm që operojnë në Kosovë; KEDS-i; linjat e Ibër-Lepencit në sistemin GIS; mbledhja e informatave të institucioneve publike etj.

Tani ka përfunduar zonimi i zonës urbane dhe zonës rurale ku së shpejti pritet të fillojnë edhe diskutimet publike me qytetarët.

Legalizimi i objekteve pa leje:

Komuna e Vushtrrisë ka angazhuar staf shtesë profesional me shërbime të vecanta për tu marrë me trajtimin e objekteve pa leje. Deri me tani kemi mbi 100 aplikime për legalizim, ku një pesë prej tyre edhe janë lëshuar certifikata të legalizimit.

Projektet për vitin 2020:

Gjatë kësaj periudhe janë duke u realizuar këto projekte kapitale sipas kontratave të lidhura mes operatorit ekonomik dhe Komunës së Vushtrrisë:

Asfaltimi i rrugëve lokale në fshatin Reznik (projekt tre vjeçar);
Asfaltimi i rrugëve në 47 fshatra tjera të Komunës së Vushtrrisë;

Shërbime Publike

Drejtoria për Shërbime Publike ka bërë përpjekje për të ofruar shërbime sa më cilësore për të gjithë qytetarët e Komunës së Vushtrrisë. Është biseduar për problemet dhe nevojat me të cilat po ballafaqohen qytetarët, si dhe janë hulumtuar mundësitë reale të zgjedhjes së këtyre problemeve. Kërkesat dhe nevojat e qytetarëve pas shqyrtimit në nivel të Drejtorisë, janë dërguar në procedura të mëtutjeshme. Është konstatuar se nevojat dhe kërkesat e qytetarëve për rregullimin e infrastrukturës dhe problemeve tjera komunale, janë shumë të mëdha por për shkak të buxhetit të limituar dhe gjendjes jo të mirë ekonomike të vetë komunitetit, zgjedhja e këtyre

problemeve është e vështirësuar, sidomos Pas paraqitjes së pandemisë COVID-19 në muajin mars të këtij viti.

Furnizimi me ujë,

Edhe në këtë 6 mujor kemi qenë të orientuar në kyçjen e të gjitha ekonomive familjare në rrjetin e ujësjellësit në të gjitha fshatrat e komunës, projekt ky i kontraktuar dhe është në implementim e sipër. Në këtë projekt do të përfshihen rreth 9000 familje. Në proces janë 5 fshatra prej të cilëve fshati Stanoc i Poshtëm dhe Bukosh veç kanë përfunduar. Gjithashtu kemi qenë të orientuar në ngritjen e kapaciteteve menaxhuese të kësaj fabrike si dhe krijimin e TASK FORCES për eliminimin e keqpërdorimit të ujit të pijes në mënyrë që të kemi furnizim më të rregullt me ujë.

Largimi i ujërave të zeza,

Në infrastrukturën e rrjetit të kanalizimit ka vazhduar implementimi i projektit – kontratës dy vjeçare për ndërtim të kanalizimit. Gjatë kësaj periudhe është vazhduar me rrjetin e kanalizimit në fshatin Nadakoc nga Agrovini, në fshatin Dalak dhe një segmente në fshatin Doberllukë.

Largimi i ujërave atmosferike,

Gjatë kësaj periudhe është bërë pastrimi i ujëmbledhëseve të prrockave dhe rrjedhave të ujit në qytet, përmes kontratës me Ndërmarrjen UNITETI.

Menaxhimi i Mbeturinave,

Me qëllim të krijimit të një ambienti të pastër përmes menaxhimit të plotë të mbeturinave, ka vazhduar së zbatuari Planin për Menaxhimin e Mbeturinave, Rregulloren për menaxhimin e mbeturinave brenda territorit të Komunës së Vushtrrisë, si dhe një varg dokumentesh që kanë derivuar nga ky plan. Tashmë shërbimet bazike të grumbullimit dhe transportimit të mbetjeve konsiderohen të përmbushura si rezultat i implementimit të plotë të Planit Operativ të ndërmarrjes. Pas përmbylljes së proceseve për shërbimet bazike, ka vazhduar proceset e ndarjes së mbeturinave në burim. Shkalla e inkasimit të mjeteve nuk ka qenë në nivel të kënaqshëm, për shkak të problemeve të paraqitura si rezultat i pandemisë COVID 19. Gjithashtu komuna ka angazhuar 6 punëtor sezonal në mirëmbajtje të hapësirave publike. Kjo praktikë e mirëmbajtjes së pastërtisë në qytet është treguar mjaft e suksesshme pasi që janë kursyer mjete të konsiderueshme financiare të buxhetit të komunës.

Ndriçimi publik,

Ka vazhduar implementimi i projektit për mirëmbajtjen e ndriçimit publik, ndërsa me investim nga komuniteti është bërë zgjerimi i rrjetit në fshatrat Nevolan dhe Vërnice.

Gjithashtu në realizim e sipër kanë qenë; ndërtimi i shtratit të lumit Podrança projekt dy vjeçar, ndërtimi i urës në fshatin Dobërllukë, dhe projekti me bashkë financim për ndërtimin e lapidarit në fshatin Kollë.

Në fushën e **mirëmbajtjes së gjelbërimit** me sukses janë realizuar projektet e planifikuara, si: Furnizimi dhe mbjellja e drunjtëve dekorativ; Plani për pastrimin, mirëmbajtjen dhe kultivimin e parqeve të qytetit;

Komunikacion,

Në kuadër të fushës së trafikut, është menaxhuar kontrata për shërbimet e transportit me auto merimangë, janë nxjerrë vendime për bllokim të shiritave rrugor dhe vendime për shfrytëzim të parkingjeve nga operatorët e transportit të udhëtarëve me Radio Taksi, vendime për ndaljen e mjeteve motorike për ngarkim shkarkim. Në fushën e trafikut ka filluar implementi i kontratës për furnizim dhe vendosje të sinjalizimit horizontal dhe vertikal në rrugët e qytetit, me qëllim të krijimit të një rrjeti funksional dhe të integruar, duke synuar rritjen e shkallës së sigurisë për të gjithë pjesëmarrësit në komunikacion, pra krijimin e kushteve për lëvizje të motorizuara dhe të pa motorizuara, duke përfshirë edhe personat me nevoja të veçanta. Po ashtu janë menaxhuar kontratat për mirëmbajtje dhe rikonstruim të rrugëve të asfaltuara dhe kontrata për mirëmbajtje dimërore të rrugëve lokale, ndërsa nga kontrata për mirëmbajtje të rrugëve të rendit të IV-të nuk ka pasur mjete për investim për shkak të tërheqjes së mjeteve për pandemi.

Në tabelën e mëposhtme janë paraqitur kilometrat e kaluara si dhe karburantet e harxhuara për automjetet e Kuvendit Komunal për periudhën Janar – Qershor 2020.

Muaji	Km të kaluara	Litra	Mesatarja
Janar	12017	1055	8.77
Shkurt	21078	1598	7.55
Mars	12248	1266	10.3
Prill	12812	1188	9.27
Maj	14674	1155	7.87
Qershor	8595	837	9.73
Total	81424 [km]	7099[l]	8.71[l/100km]

Kulturë Rini dhe Sport

Sa i përket mbarëvajtjes së punëve në këtë periudhë kohore, natyrisht, edhe ne jemi ballafaquar me pandeminë COVID-19, mirëpo përkundër kësaj me aq sa kanë lejuar mundësitë dhe rrethanat e krijuara jemi munduar që të bëjmë më së miri punën që është kërkuar dhe e cila është planifikuar nga ana jonë.

QK “HASAN PRISHTINA”

I gjithë stafi i Qendrës për Kulturë “Hasan Prishtina” aktualisht është duke vepruar në objektin e Qendrës Rinore “Naxhije dhe Fahri Buçinca”, për shkak se është duke vazhduar ndërtimi i objektit të Qendrës për Kulturë “Hasan Prishtina”. Punimet në këtë qendër janë në fazën përfundimtare, si brenda edhe jashtë objektit. Ndër aktivitetet kulturore në të cilat Qendra për Kulturë “Hasan Prishtina” ka qenë e përfshirë drejtpërdrejtë apo tërthorazi në organizim apo edhe që ka marrë pjesë, paraqesim disa prej atyre që janë cilësuar si më kryesore:

Organizimi i Akademisë për nder të Ditës së Pavarësisë më datë 17 shkurt 2020, që u mbajt në sallën e Qendrës së Kulturës, në Vushtri

Patëm filluar përgatitjet në lidhje me organizimin e Festivalit për Fëmijë, i cili do të organizohet posa të lejojnë rrethanat që u paraqitën nga Pandemia COVID-19.

Organizuar Akademi për nder të Ditës së Çlirimit, më datë 17 qershor 2020, e cila përkundër rrethanave nga Pandemia u bë e mundur të realizohet.

Stafi i Qendrës për Kulturë “Hasan Prishtina” gjatë këtij viti ka mbështetur apo organizuar të gjitha aktivitetet tjera kulturore që janë organizuar nga institucionet komunale. Po ashtu ka

ndihmuar në organizmin e aktiviteteve të shoqatave të dala nga lufta e UÇK-së dhe aktiviteteve të ndryshme në të cilat është kërkuar ndihma jonë.

BIBLIOTEKA “NAIM FRASHËRI”

Biblioteka ishte angazhuar në organizmin e manifestimeve e akademive të ndryshme që u mbajtën në komunën e Vushtrrisë gjatë periudhës janar – qershor 2020.

Të dhënat statistikore për periudhën janar – qershor 2020:

- Në sektorin për fëmijë janë dhënë për lexim 1367 libra,
- Në sektorin për të rritur janë dhënë për lexim 986 libra,
- Sallën e leximit e kanë shfrytëzuar 91 lexues,
- Janë përpunuar 192 libra, dhe
- Lexues të regjistruar 91 vetë.

Kështu, në dy sektorët e bibliotekës, janë dhënë për lexim 2353 libra. Gjatë periudhës janar – qershor 2020, në bibliotekë janë hyrë 653 libra (libra të dhuruar)

MUZEU HISTORIK – ETNOGRAFIK

PUNËT HULUMTUESE DHE IDENTIFIKIMET	janë identifikuar dhjetëra eksponate etnologjike të vjetra nëpër lokalitete të ndryshme në komunën e Vushtrrisë.
BIBLOTEKA SHKENCORE MUZEUT	Është punuar me studentë dhe lexues para dhe gjatë pandemisë duke i ofruar shënime dhe literaturë shkencore në realizimin e detyrave dhe punimeve shkencore.
INVENTRIZIMI DIGJITALI EKSPONATEVE HISTORIKE, ARKEOLOGJIKE, ETNOGRAFIKE FOLKLORIKE	<ul style="list-style-type: none"> • Inventarizimi digjital i 22 eksponateve në muze, eksponate këto të cilat ishin më parë pjesë e muzeut dhe i 10 eksponateve të cilat u dorëzuan në muze gjatë vitit 2020 • Inventarizimi dhe përshkrimi i materialit të kulturës shpirtërore të vjelur nga terreni.

Për arsye të pandemisë nuk është realizuar i gjithë planprogrami gjashtëmujor i muzeut, siç ka qenë i planifikuar.

Sektori i Rinisë

Është bërë thirrje publike për mbështetje financiare nga Komuna të OJQ-ve për thirrjet nga MKRS-ja, njëherit do t'u ofrohet mbështetje aq sa do të ketë mjete financiare.

Takime pune dhe informuese me përfaqësuesit e OJQ-ve rinore gjatë takimeve me ta është bërë planifikimi dhe janë hartuar projekt propozime dha janë dërguar për mbështetje në MKRS dhe USAID-ATRC, OSCE dhe organizata tjera.

Qendra Rinore “Hareja” ka mbajtur trajnime për shkathtësi të buta për të rinjtë vushtrrias të grup moshave të ndryshme, në fund të këtyre trajnimeve pjesëmarrësve në trajnime u janë ndarë edhe

certifikata për ndjekjen e trajnimeve. Ky projekt është mbështetur nga GIZ-i Gjerman dhe është asistuar nga sektori i rinisë.

Organizata Rinore "Acces" në bashkëpunim me sektorin e rinisë ka planifikuar që të organizojnë trajnime për të rinjtë në komunën e Vushtrrisë, është hartuar projekt propozimi dhe do të dërgohet te donatorë të ndryshëm.

Sektori i Sportit

Për shkak të pandemisë nuk kemi mund ta realizojmë zhvillimin e aktiviteteve sportive sipas planit për vitin 2020.

Në janar kemi mbajtur Manifestimin tradicional për shpalljen e laureatëve për vitin 2019, ndërsa me rastin e 17 shkurtit është mbajtur turne në basketboll për grup mosha të reja.

Palestra e sporteve "Jeton Tërstena" ka qenë e disponueshme për klubet sportive nga fillimi i vitit gjer më 13 mars kur duke iu referua rekomandimeve të Qeverisë palestra është mbyll për aktivitete.

Pas fillimit të lehtësimit të masave palestra është hapur nga 6 qershori ku klubet sportive si dhe qytetarët e kanë shfrytëzua për aktivitete sportive dhe rekreacion.

Për klubet sportive vlen të ceket rezultati i arritur nga KHF "Vushtrria" e cila është fituese e Kupës së Republikës për edicionin e garave 2019/20, dhe do e përfaqësoj Kosovën në arenën ndërkombëtare. Gjithashtu edhe kadetet e KHF "Samadrexha" janë shpallur kampione për edicionin e garave 2019/20. Ka zhgënjyer FC "Vushtrria e cila në edicionin e ardhshëm do garoj në një rang më të ulët.

Teatri i Qytetit

Më 22 janar 2020 Teatri i qytetit të Vushtrrisë ishte mysafirë në Teatrin e Suharekës me shfaqjen "Nuk do të paguajmë" me ç'rast publiku ishte i kënaqur jashtëzakonisht shumë sepse loja e aktorëve ishte në nivel, salla e stërmbushur me ardashës. Më 31 janar erdhi ftesa nga Teatri Kombëtar i Tiranës që me shfaqjen "Nuk do të paguajmë" të marrim pjesë në festivalin që organizohej nga aktorët e teatrit kombëtar, ishte një organizim i jashtëzakonshëm dhe teatri ynë mori pjesë për herë të parë me shfaqje në këtë festival ku u mirëprit nga publiku dhe kritikët e artit. Ndërsa më 14 shkurt 2020 kjo shfaqje u prezantua para publikut në Ferizaj, aty për një orë aktorët dhe mysafirët u ndien të kënaqur me paraqitjen e aktorëve të trupës së teatrit të Vushtrrisë. Në shkurt të 2020 filluam provat me teatrin e fëmijëve me shfaqjen "Akraballëket" të Kristo Floqit, me regji të Fazli Muharremit. Provat filluan në tavolinë dhe shkonin shumë mirë, mirëpo për shkak të pandemisë u detyruam që t'i ndërprejmë, mirëpo shpresojmë që me përmirësimin e gjendjes ne do t'i vazhdojmë provat për këtë shfaqje.

Gjeodezi Kadastër dhe Pronë

Gjatë periudhës 01.01.2020-30.07.2020, në Drejtorinë për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë janë kryer këto punë dhe detyra të punës:

Nr. Rend.	LENDET E ARRITURA Janar- qershor 2019	Gjithsejte
1.	KERKESAT E ARRITURA	3481
2	AKTVENDIME PER BARTJE	430

3.	AKT. PER KORRIGJIMIN E EMRAVE DHE MBIEMRA.	58
4.	AKTVENDIME PER REGJISTRIMIN E HIPOTEKAVE	50
5.	AKTVENDIME PER CREGJISTRIMIN E HIPOTEKAVE	21
6.	VERTETIME-CERTIFIKATA	290
7.	COPTIMI-NDARJE FIZIKE	112
8.	INQIZIMI I GJENDJES FAKTIKE	11
9.	Uzурpimet	1
10.	KOPJE TE PLANIT	437
11.	LISTA POSEDUESE	1501
12.	KERKESA ZYRTARE TE NDRYSHME	44
13.	Shpronësime	4
14.	LENDET NE PROCEDURE	29
15.	Kërkesa tjera(identifikim, dalje ne teren, ankesa etj).	82

Gjatë periudhës raportuese kemi zhvilluar procedurë të shpronësimit të pronës së paluajtshme për interes publik në fshatin Taraxhë (dy prona të paluajtshme) dhe dy prona të paluajtshme në Vushtri.

Gjithsejtë të hyrat buxhetore për vitin periudhën janar qershor 2020 nga drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë janë 42368.81 euro. Krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar të hyrat janë më të ulëta për 16606.69 euro si pasojë e situatës me pandemi, gjithashtu numri i lëndëve është shumë më i vogël krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar.

Gjatë periudhës raportuese zyrtarët e drejtorisë kanë kryer punë të ndryshme për nevoja të Komunës, gjegjësisht të drejtorive tjera gjatë realizimit të projekteve të ndryshme (asfaltim të rrugëve, rregullim të trotuareve, lirim të hapësirave publike etj.)

Inspektimet

Aktivitetet të paraqitur në mënyrë tabelare sipas inspektorateve

Inspektorati	Nr.i procesverbaleve	Fletparaqitje	Aktivendime/Urthëres	Mbyllje të lokaleve përkohsishtë	Gjoha mandatore	Vlera e gjobave
Inspektorët e Tregut - 4	174	-	88	6	15	5100.00€
Inspektori Sanitar - 1	72	1	407	16	3	2550.00€
Inspektorët e Ndërtimtarisë-3	42	12	18		11	7100.00€
Inspektorët e Komunikacio.-2	54	-	6			
Inspektorja e Higjienës - 1	12		30			
Totali	354	13	1488	22	29	14750,00€

TË HYRAT NGA DREJTORIA PËR INSPEKTIME

Pranime teknike	1160.00 €
Pëlqime sanitare	8414.22 €
Gjoha mandatore	14750.00 €
Pagesa e mallit nga asgjësimi	300.00€
Totali i të hyrave	24624.22€

AKTIVITETET NË FORMË TABELARE, Janar – Qershor 2020

Nr.	PËRSHKRIMI I AKTIVITETIT	SASIA	VLERA
1	AKTIVITETE INSPEKTUESE	939	
2	PROCES VERBALE	354	
3	AKTVENDIME/ URDHËRESA TË	1488	

	NDRYSHME		
4	FLETËPARAQITJE NË GJYKATË	13	
5	PRANIME TEKNIKE	17	1160.00€
6	PËLQIME SANITARE	19	8414.22€
7	PRANIME TEKNIKE TË AUTOMJETEVE		
8	MOSTRA TË USHQIMIT TË MARRURA	1	
9	MALL I LARGUAR NGA SHITJA DHE ASGJASIMI I MALLIT	19542 kg	
10	PAGESË PËR ASGJASIM TË MALLRAVE		300.00€
11	KËRKESA TË PRANUARA	119	
12	KËRKESA TË MIRATUARA	99	
13	KËRKESA TË REFUZUARA	15	
14	KËRKESA NË PROCEDURË	5	
15	DENIME MANDATORE	29	14750.00€
16	MBYLLJE TË PËRKOHSHME TË LOKALEVE AFARISTE	22	

Vlen të theksohet se nga muaji mars 2020 kur është shfaqë koronavirusi ne komunën tonë kemi qenë të angazhuar çdo ditë edhe pas orarit të punës në mbikëqyrjen e zbatimit të vendimeve të Qeverisë së Kosovës dhe të shtabit emergjent komunal për sa i përket kësaj pandemie ku kemi ndërmarr masa ndaj shkelësve të këtyre vendimeve.

Mbrojtje dhe Shpëtim

Gjatë periudhës janar-Qershor 2020, në DMSH ka pasur angazhime dhe intervenime me rastin e vërshimeve dhe fatkeqësive tjera natyrore ku është intervenuar me kompaninë e kontraktuar për angazhim në situata emergjente në terren.

Për shkak të pandemisë Covid-19 më dt.17.04.2020 u formua Qendra Operative Lokale angazhuar për përcjelljen e gjendjes për sa i përket kërkesave emergjente të qytetarëve.

Gjatë muajit shkurtë 2020 territorin e Vushtrisë e sidomos pjesën perëndimore e ka përcjellë një mot me erëra dhe stuhi të forta. Si pasojë e kësaj u dëmtuan shumë sera dhe kulme. Pas daljes në terren, komisioni ka bërë vlerësimin e dëmeve në 38 raste. Dëmet e përgjithshme janë vlerësuar në shumë prej 59,380,95 €.Për shka tëmungesës së fondit komunal emergjent, këto kërkesa janë dërguar në Ministrinë e linjes për mundësinë e kompensimit të ature dëmeve.

Preventiva dhe parandalimi


Janë bërë Inspektime të objekteve për sa i përket mbrojtjes nga zjarri ku janë marrë masa për të krijuar siguri për qytetarët.

Zyra e lajmërimit dhe alarmit

Ka bërë hartimin dhe harmonizimin e planeve të ndërlidhjes për koordinimin në situata emergjente. Këto plane janë të aplikueshme dhe në çdo situatë emergjente mund ta kryejnë funksionin e paraparë. Gjatë situatave emergjente, koordinimi dhe ndërlidhjet në mes të shërbimeve emergjente si: Policia e Kosovës, QKMF dhe Shërbimin e Zjarrfikësve me bazën, gjegjësisht Zyrën e Alarmit dhe Koordinimit Emergjent është funksional dhe në nivelin e duhur. Funksionimi i pajisjeve për ndërlidhje dhe koordinim në mënyrë të rregullt mundëson informimin me kohë të të gjitha situatave emergjente në terren. Zyra e Alarmit dhe Koordinimit Emergjent mban të gjitha evidencat e informimit, lajmërimit dhe distribuimit të të gjitha informatave.

Ky raport është paraqitur me të dhëna kryesore për punët që janë kryer brenda këtij 6 mujori nga qeveria komunale. Mirëpresim sugjerimet dhe vërejtjet e juaja gjatë shqyrtimit përkatësisht diskutimeve në mbledhje të Kuvendit të komunës.

Xhafer Tahiri



Kryetar i Komunës

I N F O R M A T Ë
lidhur me masat për mbrojtje nga virusi COVID-19
Mars – Qershor 2020

Shtabi Emergjent

1. Me datën 12 mars 2020 është themeluar Shtabi Emergjent për mbrojtje nga COVID-19 në përbërje prej 15 anëtarësh, në të cilin përveç përfaqësuesve institucional janë përfshi edhe: përfaqësuesi i organizatave rinore të komunës, përfaqësuesi i shoqatës së bizneseve, bashkësisë islame dhe kryqit të kuq në Vushtrri.
2. Shtabi ka qenë mobil 24 orë dhe ka mbajtur mbledhje varësisht prej situatës në terren, ka marr një varg masash konform vendimeve të Qeverisë dhe Ministrisë së Shëndetësisë së Kosovës.

Vendimet që janë marrë nga shtabi emergjent.

- Vendimi dt.12.03.2020 me të cilin zvogëlon stafin punues në organet e administratës së komunës – staf esencial për punë të domosdoshme pa e cenuar efektivitetin e punës, me qëllim të zvogëlimit të rrezikut për infektim me COVID-19,
- Njoftim publik për qytetarë ku qytetarët njoftohen për punën e qendrës së thirrjeve pa pagesë në komunë për të marr informatat e nevojshme për shërbime komunale.
- Vendimi dt.12.03.2020, i gjithë stafi i kujdesit primar shëndetësor të jenë në gjendje gatishmërie si dhe ndërpriten pushimet e stafit, të dezinfektohen menjëherë të gjitha objektet e institucioneve publike të komunës si dhe urdhërohet dezinfektimi i lokaleve të bizneseve (restorante kafiteritë qebaporet etj.). Të dezinfektohen objektet fetare gjithashtu. Ftesë bizneseve që mos ti ngritin çmimet duke shfrytëzuar situatën e pandemisë. Shërbimi i zjarrfikësve të jetë në gjendje gatishmërie, janë anuluar të gjitha konkurset publike për punësim.
- Urdhëresë dt. 13.03.2020 të bëhet mbyllja e të gjitha tregjeve, Inspektorati i komunës të marr masa të inspektiveve konform ligjeve dhe vendimeve të qeverisë së Kosovës, nëpunësit civil me sëmundje kronike të mos vijnë në punë derisa të krijohen mundësitë.
- Ftesë Publike, 15.03.2020 të ardhurit e komunës së Vushtrrisë nga shtete të ndryshme të vet izolojnë në shtëpitë e tyre, secili qytetarë i Komunës së Vushtrrisë që dyshon se është i prekur me koronavirus të lajmërohet në qendrën e thirrjeve në Ministrinë e shëndetësisë.
- Urdhëresë më 16.03.2020 reduktohet numri i shërbimeve komunale për qytetarë – vetëm për shërbime të domosdoshme. Secili drejtor të mbikëqyrë kryerjen e punëve të domosdoshme.
- Kërkesë Ministrisë së Shëndetësisë më 16.03.2020, për furnizim me pajisje dhe materiale shëndetësore mbrojtëse për stafin e kujdesit parësor shëndetësor.

- Vendim më 20.03.2020 mjetet në shumë prej 50,000 € të shfrytëzohen për blerje të pakove ushqimore për familje skamnore.
- Urdhëresë më 23.03.2020 urdhërohen pronarët e furrave të bukës që të sigurojnë ambalazhim të bukës, pronarët e dyqaneve gjegjësisht bizneseve private të bëjnë shenjëzimin e pritjeve në radhë në distancë prej 2 metrave. Inspektorati i komunës të mbikëqyrë zbatimin e kësaj urdhërese.
- Vendim 01.04.2020 me të cilin obligohet inspektorati i komunës menjëherë të ndërmerr të gjitha masat e nevojshme të mbikëqyrjes në Marketin “Emona Center” në Vushtri, nëse i ka zbatuar masat mbrojtëse të punëtorëve (maska, dorëza, dezinfektues) të cilët punojnë dhe të cilët mund të jenë në kontakt të drejtpërdrejtë me konsumatorë për shkak se një punëtor i këtij marketi ka dalë pozitiv.
Të bëhet kontrollimi i hapësirave të Emona Center nëse është bërë dezinfektimi i atyre hapësirave, si dhe masave tjera mbrojtëse I rekomandohet Personelit udhëheqës të marketit “Emona Center” në Vushtri që të dërgoj në vet izolim të gjithë punëtorët pasi që vlerësohet se kanë qenë në kontakt me dy punëtorët të cilat tani më është konstatuar se janë prekur nga koronavirusi COVID-19 për të iu shmangur mundësisë së përhapjes së kësaj sëmundje.
- Kërkesë Kryeministrit, Ministrit të financave dhe Ministrit të Bujqësisë 06.04.2020 për shqyrtim të mundësisë së blerjes së patateve me çmimet e tregut nga depot e kultivuesve për rezerva të shtetit, për shkak të mbylljes së tregjeve dhe lirisë së qarkullimit për qytetarë.
- Vendim, më 06.04.2020 personeli udhëheqës në markete të mëdha të kufizojnë hyrjet e jo më tepër se 15 konsumatorë. Inspektorati i komunës të mbikëqyrë zbatimin e këtij vendimi.
- Vendimi dt. 08.04.2020 Obligohen bizneset e komunës që të i pajisin punëtorët e tyre me dorëza dhe maska mbrojtëse. Poashtu të bëjnë dezinfektimin e karrocave të të gjitha llojeve pas çdo përdorimi nga konsumatorët. Asnjë biznes nuk do të iu ofroj shërbim konsumatorëve nëse nuk janë të pajisur me maska mbrojtëse dhe dorëza. Mbikëqyrjen e zbatimit të këtij vendimi do ta bëj inspektorati i komunës.
- Vendimi dt. 10.04.2020 të gjitha këshillat e fshatrave marrin kompetenca të shtabeve lokale të emergjencës dhe bashkëpunojnë ngushtë me shtabin komunal për emergjencë, policinë e Kosovës etj.
- Rekomandim dt. 10.04.2020 iu rekomandohet bizneseve private – marketeve që me rastin e furnizimit me pemë dhe perime të iu japin prioritet blerjes së prodhimeve nga prodhues të komunës së Vushtrrisë.
- Vendim dt. 14.04.2020, të vendosen dy tunele dezinfektuese në vendet më të frekuentuara në qytet.
- Kërkesë Ministrisë së Bujqësisë dt. 15.04.2020 për subvencionim të bujqve për ujtitje të tokave bujqësore.
- Vendim dt. 15.04.2020 për aktivizim të qendrës lokale operative emergjente në shërbim për qytetarë 24 orë.
- Më 17.04.2020 – Çështjet e diskutuara: Rasti i vdekjes së një qytetari në fsh. Smrekonicë, nevoja për pako për rimëkëmbje ekonomike, vazhdimi i mësimin on-line nëpër shkolla etj.

- Më 24.04.2020 (mbledhje e radhës e shtabit emergjent), - Gjendja ne terren: nuk kemi raste të reja të të dyshuarëve me këtë virus. Të vazhdohet me masa preventive për mbrojtje nga COVID- 19.
- Më 06.05.2020 (mbledhje e radhës e shtabit emergjent), Gjendja ne terren: nuk ka raste të reja të të dyshuarve me këtë virus. Janë sigurua nga donatorë të ndryshëm një numër i konsideruar i llatopëve për nxënës të familjeve në gjendje të vështirë materiale për zhvillim të mësimi në distancë. Të vazhdohet me masa preventive për mbrojtje nga COVID- 19.
- Më 12.05.2020 (mbledhje e radhës e shtabit emergjent), - U kërkua të merren masa preventive që gjendja në terren të mos përkeqësohet.
- Më 20.05.2020 (mbledhje me drejtor të drejtorive), - U shqyrtuan masat që po merren për mbrojtje nga COVID-19. U kërkua që të merren masa shtesë që gjendja në terren të mos përkeqësohet.
- Më 22.05.2020 (mbledhje e radhës e shtabit emergjent), - U shqyrtuan rastet e reja të të infektuarve me COVID. U kërkua të merren masa preventive që gjendja në terren të mos përkeqësohet.
- Më 31.05.2020 (mbledhje në distancë e shtabit emergjent), - lidhur me vendimin e Qeverisë së Kosovës për hapje të Çerdheve të fëmijëve nga data 01.06.2020. Me qëllim të përgatitjeve sa më të mira u vendos që çerdhja publike në Vushtrri t të hapet më 02 ose 03.06.2020.
- Më 05.06.2020 (mbledhje e radhës e shtabit emergjent), - Vendimet nga kjo mbledhje: Fëmijët e klasave të nënta familjet e të cilëve janë infektuar me COVID-19 të mos paraqiten në shkolla. Të shpërndahen 100 pako ushqimore dhe higjienike për familjet në gjendje të rëndë sociale.
- Më 08.06.2020 (mbledhje në distancë e shtabit emergjent), - Për shkak të shtimit të rasteve me COVID, u vendos që të mbyllet çerdhja publike në qytet.
- Më 12.06.2020 (mbledhje e radhës e shtabit emergjent), - Për shkak të rritjes së numrit të të infektuarve u vendos që të mbyllet shkollat deri në një vendim tjetër.
- Më 22.06.2020 (mbledhje e radhës e shtabit emergjent), - Për shkak të rritjes së numrit të të infektuarve, inspektorët të shtojnë masat e inspektimeve në terren.

Ofrimi i shërbimeve për qytetarë gjatë kësaj periudhe

Nuk ka pas ndërprerje të ofrimit të shërbimeve të nevojshme për qytetarë. Në secilën Drejtori – Sektorë është caktuar nga një zyrtar për punë me palë. Shërbimet që janë krye kanë qenë kryesisht për lëshim të dokumenteve personale (certifikata të ndryshme) por edhe sektorë tjerë.

Drejtoria e Administratës po ashtu ka vu në dispozicion Qendrën e Thirrjeve pa pagesë dhe Qendrën për Shërbim me qytetarë.

Respektimi i masave nga qytetarët (sa raste janë evidentuar si shkelje të këtyre masave)

Inspektorati i Komunës ka marr te gjitha masat e parapara nga vendimet e Ministria e Shëndetësisë dhe pothuaj se 90% te këtyre masave janë zbatuar nga qytetarët gjithnjë ne bashkëpunim me Policin e Kosovës, ndërsa aty ku nuk janë respektuar masat janë marr masa koform ligjeve ne fuqi.

Janë mbyllur lokale hoteliere dhe 5 dyqane tjera për mos respektim të vendimeve, dhe janë shqiptuar gjoba, ndërsa në bashkëpunim me Policinë e Kosovës janë iniciuar raste të veprave penale.

Ekipet mjekësore të QKMF-së që nga fillimi i shfaqjes së pandemisë ka qëndruar 24 orë në kufirin e Jarinjës për kontrollë shëndetësore për ata që kanë hyrë në Kosovë.

Janë ndihmuar me pako sociale të siguruara nga buxheti i komunës dhe nga donatorë të ndryshëm (rreth 3000 pako ushqimore, higjienike) për familjet në gjendje të rëndë sociale duke përfshi edhe një pjesë të tyre të cilët kanë punuar në sektorin privat dhe që kanë mbete pa punë shkaku i mbylljes së bizneseve. Në të gjitha rastet pakot iu janë dërguar në shtëpitë e tyre për të shmangur grumbullimet dhe rrezikun për infektim.

Janë ndërmarrë edhe masa dhe aktivitete tjera që nuk kemi përfshi në detaje, për të iu dalë në ndihmë popullatës së Komunës sonë me qëllim të ruajtjes së shëndetit të tyre nga kjo pandemi.

Vendimet më të rëndësishme përkatësisht veprimet që janë ndërmarrë nga Kuvendi i komunës, Kryetari përkatësisht Shtabi emergjent janë publikuar në faqen zyrtare të komunës.

Në mënyrë të vazhdueshme përmes mjeteve të informimit publik iu kemi bërë thirrje qytetarëve për respektim të rekomandimeve të Organizatës Botërore të Shëndetësisë, IKSHPK-së, Ministrisë së Shëndetësisë për zbatim të masave mbrojtëse nga COVID-19 me qëllim të ruajtjes së shëndetit të tyre.

Duke qenë se kjo informatë përfshinë 6 mujorin e parë të v. 2020, për periudhën e gjashtë mujorit të dytë do të njoftohet kuvendi pas përfundimit të këtij gjashtëmujori.



Xhafer Tahiri

Kryetar i Komunës